

Raporti Monitorues

**ZBATIMI I LIGJIT PËR
KONTROLLIN E DUHANIT
NË GJYKATA**

Shkumbin Spahija, Arben Lila, Florina Berisha
Kosovo Advocacy and Development Centre

Dhjetor 2013

Rr. "UÇK, 48/3-1"
10000 Prishtinë, Kosovë
info@kadc-ks.org
www.kadc-ks.org



**GJYKATAT SI NJË MODEL
PËR NDALIMIN E
PIRJES SË DUHANIT**

Merr frymë shirë

**KOSOVA PA TYM DUHANI
22 MAJ 2013**

www.kadc-ks.org



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

KADC
KOSOVO AGENCY FOR
DEVELOPMENT CENTER



Ky raport u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmblajtja është përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Përmbledhje	7
Hyrje	9
Metodologjia	11
Të gjeturat	14
Monitorimi i zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit në gjykata	14
Pirja e duhanit në vendin e punës	16
Njohuritë e personelit të gjykatave mbi dispozitat ligjore	22
Përcjellja dhe procedimi i lëndëve në gjykata	26
Konkludimet	27
Rekomandimet	29
Bibliografia	33

Përmbledhje

Në maj të vitit 2013, Kosova miratoi ligjin e ri për kontrollin e duhanit me synim të mbrojtjes së shëndetit publik, të gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit me të cilin ndalohet 100% pirja e duhanit në hapësirat e mbyllura.

Edhe pse misioni i gjykatave në Kosovë është që të sigurojë sundimin efektiv të ligjit, monitorimi i tyre ka treguar se tymosja e duhanit në ndërtesat e gjykatave nuk është kudo e ndaluar plotësisht. Vetë gjyqtarët dhe personeli i gjykatave tymosin duhan në zyrat e tyre, duke demonstruar në mënyrë të qartë mungesën e sundimit të ligjit në hapësirat e gjykatës.

Në periudhën tremujore 01 gusht deri më 30 tetor 2013 është realizuar monitorimi sistematik i zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit në shtatë gjykatat themelore të Kosovës. Monitorimi ka treguar që respektimi i Ligjit në gjykata është i pjesërishëm. Përkundër faktit që shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit janë vendosura në të gjitha gjykatat, nga vizitat është konstatuar se në 9 (nëntë) raste që ligji është shkelur herë nga personeli administrativ dhe nga vet gjyqtarët.

Edhe pse pjesa më e madhe e personelit të gjykatave është jo duhan pirëse, hulumtimi ka treguar që nuk janë të informuar për mundësinë e lajmërimit në numrin falas publik kur u shkelet e drejta e tyre për një ambient të punës pa tym duhani. Atyre u pengon pirja e duhanit nga të tjerët dhe kolegët e tyre në vendin e punës.

Të ekspozuar ndaj tymit të duhanit, respektivisht pirjes pasive të duhanit, personeli përjeton reaksion fiziologjik - djegje të syve, nevojë për ajër të pastër dhe produktivitet të zvogëluar në punë. Shumica e personelit të gjykatave është mësuar të mos reagoj fare kur në ambientin e punës janë të pranishëm kolegë që tymosin duhan dhe kolegë që nuk tymosin duhan.

Në zinxhirin e gjatë që fillon nga përpilimi i Ligjit për kontrollin e duhanit, miratimit të Ligjit në parlamentin e Kosovës dhe dekretimit nga Presidentja, ngritjes së vetëdijes së qytetarëve, zbatimit të ligjit nga autoritetet inspektuese dhe sanksionimet në rast të shkeljes, hallka më e dobët ka mbetur procedimi efikas i lëndëve të ngritura dhe sanksionimi i pa diskutueshëm dhe me kohë i subjekteve apo personave fizik në rast të mos respektimit të Ligjit.

Për ta forcuar zbatimin e ligjit nevojitet mbështetje aktive e autoriteteve inspektuese në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimit për përpilim të duhur të lëndëve, vazhdim të monitorimit dhe përcjelljes së lëndëve në gjykata për procedim më efikas të tyre, publikim të vendimeve dhe numrit të vendimeve të gjykatës ndaj subjekteve të ndëshkuara afariste.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së dukurisë së shkeljes së ligjit për kontroll të duhanit dhe përcjelljes së mesazhit të qartë se ato subjekte që shkelin Ligjin domosdoshmërisht sanksionohen dhe sanksionohen pa vonesë, të gjitha gjykatat nevojitet të trajtojnë me prioritet lëndët që kanë të bëjnë me mos respektim të ligjit e posaçërisht në sezonin e dimrit kur tendenca dhe frekuenca e shkeljeve në hapësirat e mbyllura është shumë më e lartë.

Hyrje

Shkalla e pirjes së duhanit në Kosovë është ndër më të lartat në rajon. Dizet e shtatë për qind (47%) e të rinjve e kanë provuar duhanin para moshës 18 vjeçare (IKSHP, 2005) dhe përdorimi aktual i duhanit për femrat në rajon është 44%, e dyta më e larta në botë (OBSH, 2011).

Ligji i mëparshëm për duhanin është hartuar dobët dhe nuk ka mundur të zbatohet në mënyrë efektive. Në maj të vitit 2013, Kosova miratoi ligjin e ri për kontrollin e duhanit që përfshin mbrojtjen më të fortë në botë deri më sot ndaj ndërhyrjeve të industrisë së duhanit në bërjen e politikave. Këto masa janë të bazuara në nenin 5.3 të Konventës Kornizë për Kontrollin e Duhanit (WHO Framework Convention on Tobacco Control) në kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSH) e cila poashtu ndalon 100% tymosjen e duhanit në vendet publike, vendet e punës dhe transportin publik.

Kalimi i ligjit ishte hapi i parë vendimtar drejt mbrojtjes së shëndetit publik dhe krijimin e një mjedisi pa tym në Kosovë. Megjithatë, kapacitetet e pakta dhe mungesa e strukturës organizative të qartë e autoriteteve zbatuese e ka bërë shumë të vështirë për qeverinë të veprojë dhe të filloj zbatimin e politikave të reja të kontrollit të duhanit.

Edhe pse misioni i gjykatave në Kosovë është që të sigurojë sundimin efektiv të ligjit, monitorimi i tyre ka treguar se tymosja e duhanit në ndërtesat e gjykatave nuk po zbatohet plotësisht në ndërtesat e gjykatave. Gjyqtarët dhe personeli i gjykatave tymosin duhan vet në zyrat e tyre, duke demonstruar në mënyrë të qartë mungesën e sundimit të ligjit në hapësirat e gjykatës.

Për të zbatuar politikat e reja të kontrollit të duhanit në mënyrë efektive, sistemi gjyqësor duhet të jetë i aftë për të zbatuar atë në hapësirat e gjykatës në vend të parë. Kjo e bën të pa kuptimtë dhe shumë të vështirë që një gjyqtar të ekzekutoj gjoba për qytetarët për aq kohë sa ai ose ajo apo ndonjë zyrtar tjetër në gjykatë shkel ligjin për kontrollin e duhanit duke tymosur duhan në ambientet e gjykatës.

Projekti ka synuar mbështetjen e gjykatave në Kosovë në përmirësimin e sundimit të ligjit në kuadër të institucioneve gjyqësore si dhe në mesin e popullatës së përgjithshme përmes dy objektivave. Së pari, përmirësimin e zbatimit të ligjit mbi kontrollin e duhanit në hapësirat e gjykatës dhe së dyti përmirësimin e ekzekutimit të masave për zbatimin e ligjit të lëshuara nga autoritetet e inspektimit.

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, KADC ka monitoruar zbatimin e dispozitës për ndalimin e tymosjes së duhanit brenda ndërtesave të gjykatave nga ana e personelit të gjykatës dhe ka përcjellë ekzekutimin e gjobave të lëshuara nga autoritetet e inspektoratit përgjegjës për zbatimin e ligjit mbi kontrollin e duhanit.

Metodologjia

Në periudhën gusht-tetor 2013 KADC ka bërë monitorimin sistematik të zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit në shtatë gjykata themelore të Kosovës - Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Gjiilan dhe Mitrovicë.

Monitorimi është realizuar përmes dy metodave. Metoda e parë ka qenë metoda e vrojtimit si metodë e drejtpërdrejtë në vlerësimin e respektimit dhe zbatimit të ligjit përmes vizitave të pa paralajmëruara në gjykata.

Metoda e dytë e monitorimit është realizuar përmes zhvillimit të intervistimit të drejtpërdrejtë të personelit administrativ dhe gjyqtarëve mbi zbatimin e ligjit në vendin e punës dhe përcjelljes së procedurave dhe numrit të lëndëve të kundërvajtjes të iniciuara nga organet mbikëqyrëse të parapara me ligj. Për realizimin e metodës së dytë është përpiluar pyetësori (Pyetësori - Monitorimi i gjykatave themelore për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit) mbi pirjen e duhanit në vendin e punës dhe njohuritë mbi dispozitat e reja ligjore.

Për të mundur një monitorim sistematik dhe të pa penguar nëpër gjykata është hartuar dhe nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit me Kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Memorandumi i Mirëkuptimit mes KGJK-së dhe KADC-së, 2013).

Me qëllim të informimit sa më të mirë të kryetarëve dhe administratorëve të gjykatave është përpiluar dhe lëshuar qarkorja për procedurën standarde të veprimit në rast të shkeljes së Ligjit në hapësirat e gjykatave (Qarkorja - Procedurat standarde të veprimit gjykatë).

Gjithashtu janë shpërndarë broshura informative për personelin e gjykatave për procedurat standarde në rastet e shkeljes së Ligjit të kontrollit të duhanit në vendin e punës në gjykatë (Fletëpalosja - Gjykatat si një model për ndalimin e pirjes së duhanit, KADC).

Në gjykatën themelore në Prishtinë, divizioni për kundërvajtje, në dy zyre nuk është lejuar monitorimi dhe kryerja e intervistave me pretekstin se gjyqtarët kanë qenë të zënë dhe se ata nuk ishin të informuar për memorandumit e marrëveshjes të arritur mes KADC dhe KGJK-së.

Gjatë këtyre vizitave monitoruesit kanë shpërndarë broshura informative mbi ligjin e ri të kontrollit të duhanit dhe dispozitat ligjore që dalin nga ky ligj.

Gjithsejt janë intervistuar 35 personel i gjykatave dhe 31 gjyqtarë gjatë orarit të punës prej 08:00 deri 16:00 në shtatë (7) gjykatat themelore në Kosovë me një kohëzgjatje mesatare të intervistës prej 15min deri 20min.

Tabela më poshtë paraqet numrin total të vizitave dhe intervistave të ndara sipas komunave:

Gjykata Themelore	Nr. i vizitave	Gjyqtarë	Personeli Administrativ
Prishtinë	7	2	5
Prizren	7	5	2
Gjakovë	5	5	0
Pejë	12	6	6
Ferizaj	14	5	9
Gjilan	13	4	9
Mitrovicë	8	4	4
Gjithsejt	66	31	35

Të gjeturat

Monitorimi i zbatimit të ligjit për kontrollin e duhanit në gjykata

Secila gjykatë themelore është monitoruar më së paku 5 (pesë) herë dhe janë zhvilluar gjithsej 66 intervista me gjyqtarë dhe personelin e gjykatave.

Shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit janë vërejtur në të gjitha gjykatat, në hapësira të dukshme në hyrje të gjykatave me një përjashtim të gjykatës themelore në Pejë, divizioni për kundërvajtje, e cila ishte në fazë ristrukturimi.

KADC i ka shpërndarë shenjën për ndalimin e pirjes së duhanit secilit gjyqtar dhe zyrtarëve administrativë me numrin e telefonit për lajmërimin e rasteve për shkeljen e Ligjit të kontrollit të duhanit. Këto shenja janë vendosur nëpër hapësira dhe zyre të gjykatave.

Në gjykatën themelore në Prishtinë në zyrën e një gjyqtari dhe dy zyre të divizionit për kundërvajtje është nuhatur aroma e duhanit ndërkaq roja e ndërtesës është vërejtur dy herë duke pirë duhan brenda gjykatës.

Në gjykatën themelore në Gjilan në zyrën e një gjyqtari është vërejtur tymi i duhanit.

Në gjykatën supreme hapësira e kuzhinës përdoret si hapësirë për pirje të duhanit nga gjyqtarët dhe personeli i gjykatave, veprim i cili përbën shkelje flagrante të Ligjit për kontrollin e duhanit.

Në zyrën e administratorit në gjykatën themelore në Pejë, pa prezencën e administratorit, por në prezencë të ndihmës administratorit dhe zyrtarëve të tjerë administrativë, është vërejtur tymi i duhanit. Ndërkaq, në sallën e takimeve është vërejtur prania e një shpuzoreje por nuk ka pasur aromë apo shenja të tjera të konsumimit të duhanit.

Administratorit i gjykatës themelore në Ferizaj ka paraqitur në sekretariatin e KGJK-së 4 (katër) raste të shkeljes së ligjit për kontrollin e duhanit dhe të katër personave të personelit administrativ u janë ndal nga paga mujore shuma e dënimit prej 50 eurove. Një gjyqtar në Ferizaj ka vendosur ta lerë pirjen e duhanit ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për kontrollin e duhanit.

Nga personeli administrativ ka pasur vërejtje se për shkak të hierarkisë shpeshherë stafi i administratës del jashtë të tymosë duhan kurse gjyqtarët në fshehtësi tymosin brenda në zyre.

Të gjithë të intervistuarit kanë deklaruar se e kanë zvogëluar sasinë e konsumimit të duhanit nga hyrja në fuqi e ligjit për kontrollin e duhanit.


Gjatë periudhës monitoruese inspektorati sanitar ka ngritur gjithsej 9 (nëntë) lëndë për kundërvajtje në gjykatën themelore në Prishtinë, 7 (shtatë) në Prizren ndërkaq në gjykatat tjera themelore nuk ka asnjë lëndë të ngritur. Në përfundim, nga 66 vizita monitoruese mbi respektimin e ligjit për kontrollin e duhanit nëpër gjykatat themelore të Republikës së Kosovës janë evidentuar gjithsej 9 (nëntë) raste të shkeljes së ligjit nga personeli administrativ dhe vetë gjyqtarët.

Pirja e duhanit në vendin e punës

Gjatë vizitave monitoruese janë intervistuar personeli administrativ dhe gjyqtarët mbi zbatimin e ligjit në vendin e punës dhe njohuritë që kanë ata mbi dispozitat ligjore që dalin nga ligji për kontrollin e duhanit.

Si pikënisje është hulumtuar struktura e duhan dhe jo-duhan pirësve të personelit gjyqësor. Rezultatet e anketës (fig. 1) tregojnë që pjesa më e madhe e personelit është jo-duhan pirëse 67% përballë 33% duhan pirësve, nga të cilët 24% kanë shprehur dëshirën të ndërpresin pirjen e duhanit.

Fig. 1 Struktura e (jo) duhan pirësve



Personeli i gjykatave (69%) nuk është i informuar mbi të drejtën e tyre për të lajmëruar në numrin falas 0 800 11000 (fig. 2) kur u shkelet e drejta e tyre për një ambient të punës pa tym duhani.

Përderisa 3% kanë menduar që ky numër shërben për paraqitjen e rasteve të dhunës në familje vetëm 28% e personelit gjyqësor ka qenë në dijeni që në këtë numër mund të raportohen rastet e shkeljes së Ligjit për kontrollin e duhanit.

Fig. 2 Në numrin 0800 11 000 mund të:





Fig.3 A pajtoheni me vlerësimin se pirja e duhanit e dëmton seriozisht shëndetin?



Në pyetjen lidhur me vlerësimin se pirja e duhanit dëmton seriozisht shëndetin pothuajse i gjithë personeli i gjykatave (97%) pajtohet plotësisht (fig. 3).

Fig. 4 A ju pengon pirja e duhanit nga njerëzit e tjerë në vendin e punës?





Fig. 5 Çfarë ndikimi ka pirja pasive e duhanit të ju?




Pjesës dërmuese të personelit të gjykatave (82%) u pengon pirja e duhanit nga të tjerët dhe kolegët e tyre në vendin e punës (fig. 4).

Personeli i gjykatave i ekspozuar ndaj tymit të duhanit (fig. 5) respektivisht pirjes pasive të duhanit reagon në mënyra të ndryshme. Reaksioni fiziologjik apo djegja e syve (72%) është reagimi më i shpeshtë që pasohet me nevojën për ajr të pastër (10%), gjumë të parehatshëm në shtëpi (5%) dhe me produktivitet të zvogëluar në punë (2.5%).


Përkundër këtij fakti shqetësues shumica e personelit të gjykatave (fig. 6) nuk reagon fare (86%) kur në ambientin e punës janë të pranishëm kolegë që tymosin duhan dhe në prani të kolegëve që nuk tymosin duhan. Një pjesë e vogël (7%) ndihet jo rehat kur kërkon nga duhan pirësit të ndërpresin tymosjen perderisa një pjesë tjetër poashtu e vogël (7%) ndjen një tension në mes të duhan pirësve dhe jo-duhan pirësve.

Fig. 6 Si ndjeheni kur në ambientin e punës janë të pranishëm duhan dhe jo duhan pirës?



Gjithashtu, për personelin e gjykatave (fig. 7) janë të rëndësishme edhe dëmet që u shkakton duhani në mjedisin e punës vet duhan pirësve dhe për këtë diskutohet në takime me të gjithë personelin (26%) apo brenda ambienteve të tyre të punës – në zyra (35%).

Fig. 7 A është diskutuar në mjedisin tuaj të punës për dëmet që u shkakton duhani duhanpirësve?




- Po, e kemi diskutuar në mbledhje me të gjithë të punësuarit
- Po, e kemi diskutuar me kolegë brenda zyrës sime
- Jo, nuk e kemi diskutuar asnjëherë

Njohuritë e personelit të gjykatave mbi dispozitat ligjore


Pjesa e dytë e hulumtimit është përqëndruar te njohuritë e personelit të gjykatave mbi dispozitat ligjore të ndalimit të pirjes së duhanit në vendin e punës. Të gjithë janë të informuar se ekzistojnë rregulla në lidhje me tymosjen e duhanit në vendin e tyre të punës. Mirëpo kur është fjala për tymosjen e duhanit në gjykatë hulumtimi tregon se ekziston një dallim rrënjësor mes personelit të gjykatave dhe palëve në gjykatë.

Fig. 8 A respektohet Ligji?




Nga hulumtimi (fig. 8) del se ndalimi i tymosjes në gjykatë respektohet plotësisht nga palët përderisa personeli i gjykatave mendon se 87.9% e personelit të gjykatave e respektojnë plotësisht, 10.6% pjesërisht dhe 1.5% e nuk e respekton fare ndalimin e tymosjes së duhanit në gjykatë.

Fig. 9 Cilat janë autoritetet për zbatimin e Ligjit?



Kur është fjala për njohuritë rreth autoriteteve për zbatim të ligjit (fig. 9), hulumtimi tregon që gati një e treta (30%) nuk kanë fare njohuri, gati gjysma (48.5%) mendojnë se është inspektorati sanitar dhe vetëm 21% është e saktë në pohimin se përgjegjësia e zbatimit të ligjit bie mbi një numër më të gjerë të autoriteteve inspektuese, duke përfshirë Policinë e

**Fig. 10 A jeni të kënaqur me
politikat ekzistuese në lidhje me
konsumimin e duhanit?**



Kosovës dhe agjencionin kundër korrupsionit. Ndërsa sa i përket bashkëpunimit me inspektoratin e punës për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit vetëm një i anketuar është përgjigjur pozitivisht derisa 65 të tjerë kanë pohuar që nuk ka bashkëpunim.

Pjesa më e madhe e personelit të gjykatave është e kënaqur me politikat e kontrollit të duhanit (82%) (fig. 10). Një pjesë më e vogël 18% që nuk është e kënaqur, është shprehur se ligji është vështirë i zbatueshëm dhe ka kërkuar një hapësirë të veçantë për tmosje të duhanit në hapësirat e gjykatës.

Përcjellja dhe procedimi i lëndëve në gjykata

Ligji për kontrollin e duhanit ka hyrë në fuqi me 22 maj 2013. Hyrja në fuqi në pranverë në kohë me mot të mirë ka ndikuar që ndalimi 100% brenda hapësirave publike të respektohet. Rrjedhimisht deri me fillimin e motit të ftohtë inspektorati sanitar nuk ka ngritur asnjë lëndë ndaj subjekteve afariste për mos respektim të ndalimit të tymosjes në hapësirat e mbyllura. Nga ana tjetër me hyrjen në fuqi të ligjit, industria e duhanit është kujdesur që të mos ekspozohen produktet e duhanit duke respektuar edhe dispozitën për ndalimin e ekspozimit të produkteve të duhanit në pikat e shitjes.

Mirëpo me fillimin e ftohjes së motit ka filluar shkelja sporadike e ligjit nëpër restorante nëpër të gjitha komunat e Kosovës. Kjo ka shkaktuar ngritjen e lëndëve për kundërvajtje deri në përfundimin e këtij raporti në dy komuna 8 (tetë) lëndë në Prishtinë dhe 7 (shtatë) lëndë në Prizren. Përkundër kësaj, asnjë lëndë nuk ka përfunduar dhe asnjë subjekt nuk është gjykuar për shkelje të ligjit. Sipas gjykatësit për kundërvajtje në gjykatën themelore në Prishtinë, një lëndë e ngritur ndaj një subjekti afarist në Prishtinë nga inspektorati sanitar është e mangët me dëshmi konkrete për tymosjen e duhanit brenda restorantit (subjektit afarist) që e bënë shumë të vështirë gjykimin e lëndës në dobi të inspektoratit. Sidoqoftë, kjo është vetëm njëra nga 8 (tetë) lëndët e ngritura që ka filluar të shqyrtohet në gjykatën themelore në Prishtinë, divizioni për kundërvajtje. Lëndët tjera ende nuk kanë filluar të shqyrtohen nga gjykatësit për kundërvajtje.

Konkludimet

Respektimi i Ligjit për kontrollin e duhanit në hapësirat e gjykatave themelore që nga hyrja e ligjit në fuqi me 22 maj 2013 është i pjesërishëm. Përkundër faktit që shenjat për ndalimin e pirjes së duhanit janë vendosur në të gjitha gjykatat, nga vizitat monitoruese është konstatuar që ligji është shkelur 9 (nëntë) herë nga personeli administrativ dhe nga vetë gjyqtarët. Për më tepër, për shkak të hierarkisë, personeli administrativ ka dalë jashtë për të tymosur duhan kurse gjyqtarët në fshehtësi kanë tymosur brenda në zyre. Në kontrastë me këtë gjatë vizitave monitoruese është vërejtur një vetëdije më e lartë nga qytetarët apo palët në gjykatë për respektimin e plotë të ndalimit të tymosjes në hapësirat e gjykatës.

Edhe pse pjesa më e madhe e personelit të gjykatave është jo-duhan pirëse, një pjesë e madhe e personelit të gjykatave nuk është e informuar për mundësinë e lajmërimit në numrin falas publik kur u shkelet e drejta e tyre për një ambient të punës pa tym duhani. Pjesës dërmuese të personelit të gjykatave u pengon pirja e duhanit nga të tjerët dhe kolegët e tyre në vendin e punës.

Të ekspozuar ndaj tymit të duhanit respektivisht pirjes pasive të duhanit, personeli përjeton reaksion fiziologjik - djegje të syve, nevojë për ajr të pastër, gjumë të parehatshëm në shtëpi dhe produktivitet të zvogëluar në punë. Në mungesë të udheheqjes dhe përkrahjes së qartë nga udhëheqësia e gjykatave - kryetarët dhe administratorët, si dhe nga mungesa e shembullit të mirë, shumica e personelit të gjykatave nuk reagon fare kur në ambientin e punës janë të pranishëm kolegë që tymosin duhan dhe kolegë që nuk tymosin duhan.

Personeli i gjykatave është i informuar se ekzistojnë rregulla në lidhje me tymosjen e duhanit në vendin e tyre të punës. Mirëpo, pothuajse një e treta e tyre nuk kanë fare njohuri se cilat janë autoritetet kompetente për zbatim të ligjit. Vetëm një e pesta e personelit është e saktë në pohimin se përgjegjësia e zbatimit të ligjit bie mbi një numër më të gjerë të autoriteteve inspektuese, duke përfshirë edhe Policinë së Kosovës dhe agjencionin kundër korrupsionit.

Përpilimi dhe lëshimi i qarkores për të gjitha gjykatat mbi procedurën standarde të veprimit në rast të shkeljes së Ligjit për kontrollin e duhanit në hapësirat e gjykatës ka pasur një efekt të vetëdijësimit mbi përgjegjësitë e administratorit dhe kryetarit të gjykatave që dalin nga ky ligj.

Në rastin e gjykatësit për kundërvajtje në gjykatën themelore në Prishtinë pretendohet se lënda e ngritur kundër një subjekti afarist në Prishtinë nga inspektorati sanitar ka qenë e mangët me dëshmi konkrete të shkeljes së Ligjit. Kjo mënyrë e përpilimit dhe procedimit të lëndës në gjykatë nga inspektorati sanitar e bënë shumë të vështirë gjykimin e lëndës në dobi të inspektoratit dhe rrjedhimisht humbjen e besimit në sistemin gjyqësor.

Në komunën e Prishtinës dhe Prizrenit inspektorati sanitar ka ngritur 15 lëndë për kundërvajtje ndaj subjekteve afariste dhe personave përgjegjës për zbatim të ligjit. Deri në përfundim të këtij raporti asnjë lëndë nuk ka përfunduar dhe asnjë subjekt nuk është gjykuar për shkelje të ligjit për kontrollin e duhanit.

Rekomandimet

Për përmbushjen e qëllimit që gjykatat e Kosovës të jenë model i sundimit të ligjit përmes respektimit të ndalimit të tymosjes së duhanit pikë së pari në hapësirat e gjykatave dhe jo të mbesin apo shndërrohen në hapësira ku ndodh shkelja e Ligjit nga personeli i gjykatave, nevojitet vendosmëri dhe këmbëngulësi e kryetarëve, administratorëve të gjykatave dhe Kryesuesit të Këshillit Gjyqësor të Gjykatave. Monitorimi i shpeshtë dhe i paparalajmëruar është njëra nga veglat që do të jepte rezultate konkrete në respektimin e ligjit në hapësirat e gjykatave.

Lajmërimi nga vetë qytetarët dhe personeli i gjykatave në numrin publik falas është shumë i nevojshëm dhe i domosdoshëm për zbatim të ligjit. Kësaj duhet t'i paraprijë ngritja e vetëdijes për të drejtën e patjetërsueshme të personelit të gjykatave për një ambient të punës pa tym duhani dhe thyerjen e tabuve për paraqitje të kolegëve që tymosin duhan në vendin e punës të administratori, kryetari i gjykatës apo inspektori i punës.

Për ta forcuar hallkën më të dobët të zinxhirit të Ligjit për kontrollin e duhanit, hallkën e zbatimit të Ligjit nevojitet mbështetje aktive e autoriteteve inspektuese në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimit për përpilim të drejtë të lëndëve, vazhdim i monitorimit dhe përcjellje e lëndëve në gjykata për procedim më efikas të tyre, publikimi i vendimeve dhe numrit të vendimeve të gjykatës ndaj subjekteve të ndëshkuara afariste.

Me qëllim të parandalimit të përhapjes së dukurisë për shkelje të ligjit për kontroll të duhanit dhe përcjelljes së mesazhit të qartë që ato subjektet të cilat shkelin Ligjin domosdoshmërisht sanksionohen dhe sanksionohen pa vonesa, të gjitha gjykatat nevojitet të trajtojnë me prioritet lëndët që kanë të bëjnë me mos-respektim të ligjit e posaçërisht në sezonin e dimrit kur tendenca dhe frekuenca e shkeljeve në hapësirat e mbyllura është shumë më e lartë.

Të caktohet kodi unik për gjobat mandatore për unifikimin e formularëve të gjobave mandatore për të gjitha organet zbatuese të ligjit për kontrollin e duhanit duke përfshirë edhe Policinë e Kosovës.

Bibliografia

IKSHP. Instituti Kombëtar i Shëndetit Prishtinë - Hulumtimi gjithëpërfshirës i duhan pirjes te të rinjët në Kosovë. Prishtinë. (2005)

OBSH. Përdorimi i duhanit dhe substancave psiko-aktive tek shtatëzënat në Kosovë. (2011)

WHO Framework Convention on Tobacco Control. (n.d.). <http://www.who.int/fctc/en/>.

Pyetësori - Monitorimi i gjykatave themelore për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit. (2013).

Memorandumi i Mirëkuptimit mes KGJK-së dhe KADC-së. (19 korrik 2013).

Qarkorja - Procedura Standarde e Veprimit në Gjykatë. (2013).

Fletëpalosja - Gjykatat si një model për ndalimin e pirjes së duhanit, KADC. (2013)

Qendra Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2009 e përkushtuar për përmirësimin e cilësisë së jetës përmes informimit dhe fuqizimit të zërit të publikut në politikat shëndetsore, mjedisore dhe në proceset e vendim marrjes.

KADC përbëhet nga një staf i kualifikuar me prejardhje të ndryshme profesionale që së bashku sjellin më shumë se 20 vjet përvojë në menaxhim dhe zhvillim të projekteve. Organizata është e angazhuar në mënyrë aktive për ngritjen e vetëdijes për rreziqet e konsumimit të produkteve të duhanit dhe ka një rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit për kontrollin e duhanit.



Ky raport u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja është përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Avokim dhe Zhvillim (KADC) dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.